



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Nr. Prot. Org. Jedinica Org. Unit	M-01	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	2168/26
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	03	Data Datum Date:	27.04.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Zivotne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me nenin 11, nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 34/2022), të neneve 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/2019), nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Ministrive, nenet 13, 28, 41, 71, 75 dhe 76 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2013), Rregulloren MMPH Nr. 02/2016 për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike, Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Raportin nga Inspektimet e Jashtëzakonshme për hidrocentralet në Republikën e Kosovës Nr. Prot. 880-2/26, datë 02.04.2026, si dhe dispozitave të tjera ligjore të ligjit në fuqi, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Fillimin e Zbatimit të Procedurave për Ndërprerjen e Lejes Ujore të Hidrocentraleve të Vogla

1. Hidrocentralet e vogla me derivacion futen në procedurën e ndërprerjes së Lejes Ujore, nëse brenda afatit 6-mujor nuk arrijnë të zbatojnë kriteret e Rregullores për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike (PPE) Nr. 02/2016, duke përfshirë edhe instalimin përkatës të pajisjeve ujëmatëse.
2. Veprat ujëmarrëse të hidrocentraleve, varësisht prej rastit, duhet korrigjuar ashtu që strukturalisht të pamundësohet shfrytëzimi i ujit për hidrocentral para se në rrjedhën e poshtme të jetë siguruar rrjedha e Prurjes së Pranueshme Ekologjike dhe prurjet për qëllime të tjera prioritare.
3. Operatori nuk mund të operojë pa Rregulloren përkatëse të punës, operimit dhe monitorimit, të aprovuar nga ARPL, pas testimit të funksionalitetit përkatës të veprave ujëmarrëse dhe shtigjeve të peshkut në raport me pajisjet ujëmatëse.
4. Autorizohet ARPL që, në harmoni me pikat paraprake të këtij vendimi, të lëshojë "Urdhëresa Ujore" sipas detyrës zyrtare, veç e veç, për të gjitha hidrocentralet e inspektuara brenda afatit 45-ditor, me përshkrim strikt të kriterëve rregullative e eksplicite të veprimtarisë së hidrocentralit për zbatimin e rregullores tematike të PPE-së, duke përcaktuar në dispozitiv të vendimit edhe vlerat e sasive të PPE-së sipas periodave rregullative mujore ose 10-ditëshëve.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ministria, bazuar në Raportin nga Inspektimet e Jashtëzakonshme për hidrocentralet në Republikën e Kosovës me Nr. Prot. 880-2/26, datë 02.04.2026, respektivisht dokumentimin se në asnjë nga hidrocentralet e inspektuara nuk është arritur verifikimi i vlerës së Prurjes së Pranueshme Ekologjike,

sipas detyrës zyrtare në harmoni me Nenin 13.2 të Ligjit për Ujërat e Kosovës, u detyrua ta adresojë çështjen sipas këtij Vendimi.

Një nga elementet thelbësore të sistemit është garantimi i Prurjes së Pranueshme Ekologjike (PPE), e cila siguron ruajtjen e ekosistemeve ujore dhe biodiversitetit. Rregullorja e MMPH Nr. 02/2016 përcakton këtë standard si detyrim ligjor.

Megjithatë, është konstatuar se një pjesë e madhe e operatorëve:

1. nuk kanë përcaktuar PPE-në në mënyrë të verifikueshme;
2. nuk kanë instaluar pajisje ujëmatëse të certifikuara;
3. nuk kanë sistem të monitorimit rregullativ dhe as sistem të monitorimit në kohë reale.

Këto mangësi krijojnë pamundësi për kontroll efektiv dhe rrezik të drejtpërdrejtë për degradimin e mjedisit. Mosmarrja e këtij vendimi do të rrezikonte:

- degradimin e ekosistemeve ujore dhe humbjen e biodiversitetit;
- shfrytëzimin e pakontrolluar të ujërave;
- cënimin të interesit publik dhe të së drejtës për mjedis të shëndetshëm;
- dobësimin e autoritetit ligjzbatues të institucioneve;
- do të ishte në kundërshtim me parimin e kujdesit paraprak.

Në anën tjetër, zbatimi i këtij vendimi sjell përfitime të rëndësishme:

- garantim të matjes së saktë dhe të verifikueshme të prurjeve ujore;
- forcim të zbatimit të legjislacionit mjedisor;
- rritje të transparencës dhe përgjegjshmërisë së operatorëve;
- mbrojtje të ekosistemeve ujore dhe biodiversitetit;
- përmirësim të kontrollit institucional dhe monitorimit rregullativ, si dhe monitorimit në kohë reale.

Në këtë mënyrë, vendimi është proporcional, i domosdoshëm dhe në funksion të interesit publik dhe mbrojtjes së resurseve ujore të Republikës së Kosovës. Vendimi është i balancuar (proporcional në kuptimin strikt) sepse:

1. nuk ndërpret menjëherë aktivitetin ekonomik;
2. parashikon afat tranzitor prej 6 muajsh;
3. u jep operatorëve mundësi përshtatjeje;
4. lejon vazhdimin e aktivitetit pas përmbyshjes së kushteve.

Kështu balancohet interesi publik për mbrojtjen e mjedisit me interesin ekonomik të operatorëve. Afati prej 6 muajsh konsiderohet:

- i mjaftueshëm teknikisht për realizimin e studimeve hidrologjike;
- i arsyeshëm për instalimin e pajisjeve ujëmatëse;
- proporcional me kompleksitetin e ndërhyrjeve në terren;
- në përputhje me parimin e gradualitetit në zbatimin e detyrimeve mjedisore.

Pika 1 e dispozitivit të Vendimit është në përputhje me Nenin 76 (Ndërprerja e Lejes Ujore) të Ligjit për Ujërat e Kosovës 2013: “1. E drejta e fituar me lejen ujore, ndërpritet: 1.5. me revokim, nga ana e lëshuesit të lejes, për shkak të mosrespektimit të kushteve të lejes”.

Pika 2 e dispozitivit të Vendimit është në përputhje me Nenin 28 (Përparësitë e shfrytëzimit të ujërave) të Ligjit për Ujërat e Kosovës 2013, ku hidrocentrali radhitet i 4-ti pas prioriteteve të tjera.

Pika 3 e dispozitivit të Vendimit është në përputhje me Nenin 41.3 të Ligjit për Ujërat e Kosovës 2013. Citat: “Bartësi i së drejtës ujore është i detyruar që të ketë rregullat për përdorim dhe mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve ujore”.

Pika 4 e dispozitivit të Vendimit është në përputhje me “Shtojcën 1: Akte ujore të cilat i lëshon Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore”, të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore.

Pika 5 e dispozitivit të Vendimit është në përputhje me nenin 51 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kabinetit të Ministres së MMPH-së;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së;
- Inspektorati i Ministrisë ;
- ARPL;
- Divizionit për Komunikim Publik;
- Të gjitha komunave

Fitore Pacolli Dalipi:

Ministre e Ministrisë së Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor